

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LUSHNJE**

Nr. 1268 Prot

Lushnje, më 10/02/2022

Lënda: Shkresë përcjellese

**KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE**

**TIRANË**

Mbeshtetur ne nenin 79 te ligjit Nr 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 6, date 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, Kryetarja e Bashkisë ka marr vendimin nr.163 datë 25.01.2022 “Për përdorimin dhe afishimin e çdo materiali për propagandë zgjedhore”.


Vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnje [www.bashkialushnje.gov.al](http://www.bashkialushnje.gov.al).

Bashkangjitur gjeni kopje të vendimit nr 163 datë 25.01.2022.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARE E BASHKISË**

**Eriselda Sefa**





REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

KRYETARI

Nr 785 Prot

Lushnje 25/01/2022

VENDIM

Nr. 163 Datë 25/01/2022

**“PËR PËRDORIMIN DHE AFISHIMIN E ÇDO MATERIALI PËR PROPAGANDË  
ZGJEDHORE “**

Mbeshtetur ne nenin 79 te Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” I ndryshuar, si dhe neni 3,pika 1 te Udhëzimit nr. 6, date 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

**VENDOSA :**

1. Afishimi i çdo materiali tjetër statik për propogandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohen vetëm në një largësi prej 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjekti zgjedhor përkatës.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake.

**KRYETARE E BASHKISË**

Eriselda Sefa

